AKTIV

SHPALOSJA E SFIDAVE TË SIGURISË PËRBRENDA KOMUNITETIT SERB NË KOSOVË

MITROVICA E VERIUT, NËNTOR 2023.

Përmbajtja

Hyrje..... 5
Siguria lokale në veri të Kosovës: përgjigjet institucionale..... 9
Perceptimi i serbëve të Kosovës për sigurinë..... 15
Zgjedhjet lokale në veri - pjesëmarrja politike e serbëve të Kosovës..... 21
Rreziqet e sigurisë dhe pasojat për ushtrimin e të drejtave të tjera..... 25
Sigurimi i të drejtave pronësore..... 27
Disbalanca ekonomike..... 29
Sfidat në ruajtjen e vlerave demokratike..... 30
Dialogu i Brukselit: Nga normalizimi i marrëdhënieve në menaxhimin e krizës..... 31
Përmbyllja dhe rekomandimet..... 35

HYRJE

Në vazhdimësi të trendit negativ i cili filloi pas krizës së shkaktuar nga mosmarrëveshja rreth përdorimit të targave vitin e kaluar, në vitin 2023 erdhi deri te përkeqësimi i mëtejshëm të situatës së sigurisë në veri të Kosovës. Kjo krizë kulmoi në nëntor të vitit 2022 kur serbët u larguan nga institucionet e Kosovës, duke çuar në sfida serioze kur bëhet fjalë për ruajtjen e sigurisë lokale në veri të Kosovës. Prania e vazhdueshme e Forcave Speciale të Policisë së Kosovës dhe një sërë incidentesh ndjeshëm kanë cenuar ndjenjën personale të sigurisë së serbëve të Kosovës. Kjo gjendje e krizës së përhershme pothuajse tërësisht e ka zhvendosur fokusin nga temat e tjera në aspektin e sigurisë, ndërsa rreziqet e sigurisë kanë ndikuar negativisht në shumë fusha të tjera.

Përkundër faktit se përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare, të cilët janë ndërmjetësues në dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, kanë bërë përpjekje të konsiderueshme në tentativat për të de-përshkallëzuar situatën në terren, deri më tani në këtë drejtim nuk është bërë ndonjë përparim domethënës. Edhe pse në shkurt të vitit 2023, me ndërmjetësimin e BE-së, në Bruksel u arrit Marrëveshja për rrugën e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë,[1] dhe një muaj më vonë Aneksi i kësaj marrëveshjeje në Ohër,[2] zbatimi i tyre qëndron ende në vend. Si rezultat i zgjedhjeve lokale të mbajtura më 23 prill në katër komuna në veri, të cilat u bojkotuan masivisht nga serbët lokalë, entuziazmi fillestar në lidhje me këto marrëveshje u shua shpejt dhe çështjet e sigurisë u kthyen në fokus. Që atëherë, menaxhimi i krizës u bë përsëri prioriteti i ndërmjetësuesve ndërkombëtarë, ndërsa normalizimi i marrëdhënieve përsëri ra në plan të dytë.

Pas incidentit të datës 24 shtator 2023 në Banjskë, kur një grup i serbëve të armatosur lokalë u përleshën me pjesëtarët e policisë së Kosovës, pati pezullim të plotë të dialogut dhe ndoshta përkeqësim më domethënës të situatës së sigurisë që nga trazirat e marsit të vitit 2004[3] dhe vënia e zjarrit në Jarinje dhe Bërnjak në 2008[4]. Konflikti rezultoi me vrasjen e një pjesëtari të Policisë së Kosovës dhe tre serbëve lokalë të armatosur, ndërsa për shkak të pretendimeve ende të pakonfirmuara për përfshirjen e institucioneve të Serbisë në këtë ngjarje, raporti i forcave në dialogun e Brukselit ndryshoi ndjeshëm. Nga një palë më konstruktive, siç e panë ndërmjetësuesit në dialog për një vit e gjysmë, Serbia u gjend nën kërcënimin e vendosjes së masave si ato që BE-ja tashmë ia prezantoi qeverisë së Kosovës në qershor 2023 sepse refuzoi të kontribuoi në de-përshkallëzimin e situatës në veri të Kosovës.

Ky raport, për shkak të përkeqësimit drastik të situatës në terren, synon të analizojë në detaje situatën e sigurisë në veri të Kosovës, si dhe ndikimet negative në çështje të tjera me rëndësi për mbarë komunitetin serb si pasojë e drejtpërdrejtë e këtij zhvillimi. Raporti duke përdorur të dhënat e disponueshme publikisht nga institucionet e Kosovës dhe Serbisë, gjetjet nga fokus grupet me qytetarë të kombësisë serbe dhe hulumtimet e

1 E arritur në Bruksel më 27 shkurt 2023, teksti në gjuhën angleze në dispozicion në https://www.eeas.europa.eu/eeas/belgrade-pristina-dialogue-eu-proposal-agreement-path-normalisation-between-kosovo-and-serbia_en.
2 E arritur më 18 mars 2023, teksti në gjuhën angleze në dispozicion në https://www.eeas.europa.eu/eeas/belgrade-pristina-dialogue-implementation-annex-agreement-path-normalisation-relations-between_en
3 https://press.un.org/en/2004/sc8056.doc.htm
4 https://www.slobodnaevropa.org/a/1044758.html

opinionit publik, duke u mbështetur në gjetjet nga monitorimi i pavarur i organizatave të shoqërisë civile nga Kosova (Platforma Empirika[5]) dhe institucionet ndërkombëtare, synon të ofrojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse rreth gjendjes dhe perceptimeve për sigurinë e komunitetit serb në Kosovë. Pavarësisht përpjekjeve për të mbledhur të dhëna sa më gjithëpërfshirëse nga të gjithë akterët relevant, mangësia kryesore e raportit qëndron në pamundësinë për të mbledhur të dhëna zyrtare në trajtimin e incidenteve të raportuara të sigurisë për faktin se Policia e Kosovës nuk iu përgjigj kërkesave për informacion lidhur me këto raste të raportuara.[6] Prandaj, të dhënat e përdorura janë marrë nga burime të disponueshme publikisht dhe duke u bazuar në monitorimin e kryer nga Grupi Qytetarë për Reagim të Shpejtë (ang. Rapid Response Civic Group – RRCG).[7]

Raporti është i strukturuar ashtu që, pas pjesës hyrëse që analizon kontekstin e përgjithshëm të sigurisë, veç e veç analizon zonat e prekura drejtpërdrejt ose tërthorazi nga këto çështje sigurie. Raporti fillimisht ka të bëjë me punën e institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë së Kosovës në veri të Kosovës, të cilat veçanërisht po përballen me sfida pasi në fund të vitit të kaluar u braktisën nga serbët lokalë. Pastaj, një kapitull i veçantë i kushtohet analizës së incidenteve të sigurisë ndaj komunitetit serb në Kosovë, të cilat kanë ndikuar negativisht në përvojën personale të sigurisë së serbëve të Kosovës. Kapitulli tjetër analizon pjesëmarrjen politike të serbëve të Kosovës në institucionet e Kosovës, me fokus në zgjedhjet lokale të mbajtura në prill të vitit 2023. Një kapitull tjetër trajton analizën e pasojave të rreziqeve të sigurisë në realizimin e të drejtave të tjera të serbëve të Kosovës, siç janë e drejta në pronë, e drejta për informim dhe të drejtat ekonomike. Kapitulli i fundit trajton më në detaje vetë dialogun e Brukselit dhe ndikimin e nevojës së vazhdueshme për menaxhim të krizës në normalizimin e marrëdhënieve në kuadër të negociatave që Serbia dhe Kosova po zhvillojnë nën ndërmjetësimin e ndërkombëtarëve. Krejt në fund janë dhanë rekomandimet për tejkalimin e situatës aktuale, duke marrë parasysh kornizën ekzistuese ligjore dhe të arriturat në dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës.

5 Më shumë rreth platformës shih: https://ngoaktiv.org/advocacy-hub/

6 Lulzim Peci, (Qershor 2023). *Jačanje institucionih odgovora na bezbednosne incidente u nevećinskim zajednicama (srpskim),* OJQ Aktiv, Mitrovicë, f. 6.

7 Më shumë rreth këtij mekanizmi, shih: https://peacefulchange.org/wp-content/uploads/2020/12/25-November-Case-Study-RRCG.pdf

Siguria lokale
në veri të Kosovës:
përgjigjet institucionale

Komuniteti serb në veri të Kosovës është i ekspozuar ndaj rreziqeve të konsiderueshme të sigurisë, të cilat dolën në pah veçanërisht pas largimit të serbëve lokalë nga institucionet e Kosovës në nëntor të vitit të kaluar. Për rikujtim, pasojë e zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit nga viti 2013[8] ishte integrimi i policisë serbe, organeve gjyqësore dhe një pjese të organeve të vetëqeverisjes lokale në kornizën institucionale të Kosovës. Me largimin e serbëve të Kosovës nga këto institucione, de fakto u pezullua Marrëveshja e Brukselit dhe situata e sigurisë në terren u përkeqësua ndjeshëm.

Gjatë nëntorit të vitit 2022, si pasojë e vendimit që pasoi me suspendimin e komandantit të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Kosovës në Mitrovicën e Veriut për refuzimin e shqiptimit të gjobave dhe konfiskimin e veturave që nuk kanë targa RKS nga ana e Policisë, gjithsej 547 policë të komunitetit serb nga veriu i Kosovës janë larguar nga Policia e Kosovës.[9] Kjo, përkundër faktit se një numër i caktuar i shqiptarëve mbetën në përbërje të policisë dhe përpjekjeve të Qeverisë së Kosovës për të vendosur policë shtesë nga departamentet e tjera policore, kryesisht shqiptarë, në veri të Kosovës shkaktoi një vakum sigurie. Ndërkohë, u hapë konkursi për plotësimin e pozitave të lira dhe në korrik të vitit 2023, 74 policë shtesë, të gjithë pjesëtarë të komuniteteve joshumicë, duke përfshirë edhe 45 serbë janë caktuar në veri.[10] Megjithatë, edhe një polici e përforcuar nuk ishte në gjendje t'i përgjigjej sfidave të sigurisë, që u rëndua edhe më shumë nga fakti se vetëm pak muaj më vonë edhe 9 komandantë të sapo rekrutuar dhanë dorëheqjen. Po ashtu, në gjysmën e parë të vitit 2023, numri i veprave penale të raportuara në stacionet policore në veri është zvogëluar, gjë që tregon se kjo situatë ka tronditur edhe më shumë besimin e serbëve lokalë në policinë e Kosovës.[11] Përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në polici, përveç që është i garantuar me ligjet e Kosovës, është gjithashtu një standard i njohur ndërkombëtarisht kur bëhet fjalë për punën demokratike të policisë sepse kontribuon në besimin, rrit legjitimitetin e institucionit në mesin e komunitetit joshumicë dhe përmirëson ndërveprimin e policisë me civilë.[12]

Megjithatë, për shkak të pranisë së shtuar të njësive speciale të policisë në veri puna e policisë së rregullt të Kosovës, gjatë gjithë kohës është në plan të dytë. Njësitë speciale të Kosovës shkaktojnë frikë të madhe, sepse përveç imazhit frikësues që kanë, nuk kanë asnjë pjesëtar nga radhët e popullatës lokale. Sipas të dhënave të Qendrës Humane në Mitrovicë, frika nga këto njësi është e pranishme tek rreth 77% të popullsisë lokale.[13] Ndër të tjera, për shkak të postblloqeve dhe së paku katër bazave që janë ndërtuar në veri të Kosovës për nevojat e njësive speciale, frika është e pranishme edhe tek qytetarët e thjeshtë. Veçanërisht problematike është pika në rrugën kryesore pranë Bistricës, ku policia speciale ndalon dhe legjitimon qytetarët. E gjithë kjo i kontribuoi faktit që "njerëzit e zakonshëm nuk i perceptojnë forcat speciale të policisë si dikush që është aty për t'u

8 Prvi sporazum o principima koji regulišu normalizaciju odnosa, prill 2013, në dispozicion në: https://www.kim.gov.rs/p03.php

9 *Procena statusa pravosuđa i policije na severu Kosova: uticaj i izazovi nakon ostavki kosovskih Srba*, Qendra për Avokim dhe Kulturë Demokratike, shtator 2023, f. 28.

10 Ibid, f. 29.

11 Ibid, f. 30.

12 Peyton, Kyle (2022). *Beliefs about minority representation in policing and support for diversification.* PNAS, vol. 119, nr. 52

13 Qendra Humane në Mitrovicë, *Bezbednost i etnički odnosi na Kosovu: pozicija srpske zajednice,* maj 2023, f.22.

ofruar qytetarëve siguri, por si një faktor jostabiliteti dhe represioni".[14] Ky besim u përforcua për shkak të incidenteve të shumta me civilë në të cilat morën pjesë pjesëtarë të këtyre njësive, si dhe "rasteve individuale të keqtrajtimit dhe represionit të qytetarëve nga njësitet speciale të policisë, të cilat kryesisht ndodhin në rrugën magjistrale ku nuk ka dëshmitarë apo kamera në bazë të të cilave do të ekzistonin prova materiale".[15]

Sa i përket veprimeve të policisë, është e rëndësishme të theksohet se pas gati 7 vitesh funksionimi në veri,[16] dega lokale e Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) zhvendosi stafin e zyrës së saj në Prishtinë. Për kuriozitet juridik, ndonëse, nuk ka një vendim me shkrim për zhvendosjen e IPK-së, qytetarët që tentuan të kontaktojnë këtë organ i gjetën zyrat e mbyllura.[17] Me këtë akt qytetarët nga veriu i Kosovës janë privuar nga komunikimi i drejtpërdrejtë me këtë institucion, përgjegjës për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të Policisë së Kosovës, dhe si rrjedhojë raportimi i rasteve të keqtrajtimit dhe trajtimit të pakujdesshëm ndaj të cilave serbët lokalë ishin të ekspozuar nga policia speciale është vështirësuar. Sipas të dhënave të IPK-së, ankesat për veprimet e policisë janë përndryshe të pakta në veri të Kosovës, ku sipas raportit të këtij institucioni për vitin 2022, nga gjithsej 1697 ankesa në tërë Kosovën, vetëm 3.5% janë nga rajoni i veriut.[18] Është mjaft e pritshme që në periudhën pas zhvendosjes së zyrës lokale, ky numër të ulet edhe më tej. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se në përgjigje ndaj zhvillimit të tillë të situatës, OJQ Aktiv në nëntor të vitit 2022 hapi një linjë telefonike përmes së cilës qytetarëve iu mundësua të raportojnë raste të pakëndshme, shqetësime të mundshme, përdorim të tepruar të forcës apo forma tjera të veprimit të papërshtatshëm të Njësisë Speciale të Policisë së Kosovës, por edhe të marrin informata shtesë për mënyrën e raportimit të incidenteve në institucionet kompetente të Kosovës.[19] Sipas të dhënave të kësaj organizate, në më pak se një muaj e gjysmë, pra, nga nëntori deri në fund të vitit 2022, 31 qytetarë, përmes kësaj linje, kanë raportuar incidente që kanë pasur në kontakt me policinë e Kosovës.

Kur bëhet fjalë për punën e institucioneve të drejtësisë, të gjithë pjesëtarët serbë të gjyqësorit të integruar janë larguar nga institucionet e Kosovës në të njëjtën kohë me policinë. Sipas të dhënave të disponueshme, më 7 nëntor 2022 gjithsej 25 gjyqtarë, 10 prokurorë dhe rreth 140 anëtarë të stafit mbështetës dhanë dorëheqjen nga postet e tyre.[20] Institucionet kompetente të Kosovës ende nuk kanë marrë vendime për dorëheqjet e gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë dhe aktualisht janë në proces analize. Në ndërkohë, Qeveria e Kosovës ka zhvendosur përkohësisht stafin nga rajonet tjera në veri të Mitro-

14 Fokus grup me qytetarë të komunës së Zveçanit, mbajtur më 22 shkurt 2023. Pjesë e raportit të projektit të KCSF-së.

15 Fokus grup me qytetarë të komunsë së Zubin Potokut, mbajtur më 27 qershor 2023. Pjesë e raportit të projektit të KCSF-së.

16 Zyra e IPK-së në veri është hapur në janar të vitit 2016, për më shumë informacion shih: https://ipk.rks-gov.net/News/SingleNews/6092

17 Të dhëna të bazuara në bisedat me dy qytetar të realizuara në nëntor të vitit 2023; identitet i njohur për autorët e tekstit.

18 Raporti vjetor për vitin 2022, f. 14, IPK. I qasshëm në gjuhën shqipe: https://ipk.rks-gov.net/Medias/Raporti%20Vjetor%202022%20IPK-7ed52142-c77e-4c54-8ab5-cbc3ee617d54.pdf

19 *Aktiv pokreće telefonsku liniju za prijavu slučajeva neprijatnosti od strane policije*, KoSSev info, 18 nëntor 2022. https://kossev.info/aktiv-pokrece-telefonsku-liniju-za-prijavu-slucajeva-neprijatnosti-od-strane-policije/

20 *Procena statusa pravosuđa i policije na severu Kosova: uticaj i izazovi nakon ostavki kosovskih Srba*, Qendra për Avokim dhe Kulturë Demokratike, shtator 2023, f. 13.

vicës dhe për shkak të numrit shumë të kufizuar të kandidatëve, është joreale të pritet që vendet e lira në gjyqësorë të plotësohen me përzgjedhjen e bartësve të rinj. Këtë situatë e përkeqëson edhe më shumë fakti se Qeveria e Kosovës ka pezulluar verifikimin e diplomave të marra në Universitetin e Mitrovicës së Veriut. Për shkak të kapaciteteve të reduktuara, kryesisht procedohen rastet urgjente dhe një numër i madh i lëndëve janë në pritje, ndonëse numri i lëndëve të pazgjidhura duhet të jetë në rritje.[21]

21 Ibid, 19.

Perceptimi i serbëve të Kosovës për sigurinë

Kur bëhet fjalë për sigurinë e komuniteteve joshumicë në shoqëritë multietnike, çështja kryesore gjithmonë është raporti me komunitetin shumicë dhe ndjenja e kërcënimit që ndikohet edhe nga qëndrimi i institucioneve qendrore ndaj pakicave. Prandaj, është logjike që për serbët e Kosovës çështja kryesore është ndjenja e të qenit të kërcënuar nga popullata shumicë, shqiptare, qoftë për incidente reale apo vetëm nga perceptimi se ato mund të ndodhin.[22] Në lidhje me këtë, është me rëndësi të ceket se përkundër rritjes së numrit të incidenteve ndëretnike në vitet e fundit, çka edhe dëshmon monitorimi i organizatave të shoqërisë civile të Kosovës, ka mungesë të informacionit rreth përkatësisë etnike të autorëve dhe viktimave në rastet penale, si në raporte ashtu edhe në burime të disponueshme publikisht, që ende është një mangësi e cila pengon analizën gjithëpërfshirëse.[23]

Sipas të dhënave të mbledhura nga anëtarët e RRCG-së në koordinim me OJQ AKTIV, në tre vitet e fundit ka pasur një rritje të konsiderueshme të rasteve të kërcënimit për sigurinë personale dhe pronësore në zonat e banuara me serb të Kosovës, ku u konstatua se kanë ndodhur gjithsej 163 incidente, 76 në vitin 2020 dhe 87 gjatë vitit 2021.[24] Incidentet më të shpeshta të raportuara janë rastet e vjedhjeve apo grabitjeve, të pasuara menjëherë nga sulmet fizike dhe shkaktimi i dëmeve materiale. Vetëm në tremujorin e parë të vitit 2022 janë regjistruar gjithsej 23 incidente, shumica prej të cilave në veri të Kosovës, që paraqet një rritje të lehtë në krahasim me vitin paraprak nëse kjo dinamikë do të vazhdonte deri në fund të vitit.[25] Megjithatë, përkundër shifrave të mëdha, reagimi sistematik i institucioneve të sundimit të ligjit, veçanërisht i Policisë së Kosovës dhe gjyqësorit, në lidhje me këto çështje mungon, e që edhe më tej ndikon negativisht në besimin ndaj institucioneve qendrore të pjesëtarëve serbë të Kosovës.

Prandaj, një nga gjetjet kryesore të këtij raporti është se qëndrimi i Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve të Kosovës ndaj serbëve të Kosovës është shkaku kryesor i ndjenjës së pasigurisë së tyre. Kjo ndjenjë e pasigurisë tek serbët e Kosovës, veçanërisht në veri, mund të shihet edhe përmes hulumtimit të opinionit publik të komunitetit serb, ku në vitin 2020, 70% e serbëve në veri të Kosovës e vlerësuan situatën e sigurisë si të keqe, dhe në dy vitet pasardhëse, kjo përqindje arriti në 80%.[26] Në të njëjtën kohë ekziston një dallim i dukshëm dhe domethënës në mes të veriut të Kosovës dhe komunitetit serb që jeton në jug të Ibrit, ku rreth 50% e popullsisë e vlerëson sigurinë si të dobët, gjë që tregon sërish për sfida institucionale lidhur me zbatimin e ligjit në veri. Hulumtimi i njëjtë vë në dukje edhe një trend negativ, ku më shumë se gjysma e serbëve të Kosovës presin që kushtet për mbijetesën e tyre të përkeqësohen në periudhën e ardhshme, ndërsa ka një përqindje një shifrore të atyre që besojnë se situata në Kosovë po ecën në drejtim të duhur.

22 Bojan Elek, *Bezbednost srpske zajednice na Kosovu*, f. 45-52, u ur. Miodrag Mariković, *Interesi Srba na Kosovu u procesu normalizacije odnosa između Beograda i Prištine,* shtator 2023, Qendra për Veprime Afirmative Sociale – CASA, Mitrovicë.

23 Lulzim Peci, (Qershor 2023). *Jačanje institucionih odgovora na bezbednosne incidente u nevećinskim zajednicama (srpskim),* OJQ Aktiv, Mitrovicë, f. 8

24 Ibid, f. 14.

25 Nga https://ngoaktiv.org/en/news/rising-insecurity-non-majority-communities-during-the-covid-19-pandemic/

26 *Analiza trendova: stavovi Srpske zajednice na Kosovu*, Nëtor 2022, 2021, 2020. Aktiv, Mitrovicë. https://ngoaktiv.org/wp-content/uploads/2023/03/FINAL-SRB-TREND.pdf

Të dhëna të tjera tregojnë se problemi kryesor është puna e institucioneve dhe jo domosdoshmërish marrëdhëniet ndërmjet grupeve etnike. Për shembull, përkundër perceptimit të dobët të sigurisë, serbët e Kosovës kanë pothuajse të njëjtat shqetësime si shqiptarët e Kosovës. Një hulumtim i kryer në fund të vitit 2022 zbuloi se të dyja komunitetet shqetësohen më shumë për problemet ekonomike dhe papunësinë (rreth 50%), ndërsa problemet ndëretnike janë të dytat më të rëndësishme në mesin e serbëve të Kosovës (vetëm një në pesë e përmend këtë si problem, d.m.th. 19%), që është dukshëm më shumë se në mesin e shqiptarëve të Kosovës (vetëm 4%), por jo edhe aq sa pritej.[27] Edhe pse pjesëtarët e grupit tjetër etnik shihen në një masë si shkak i pasigurisë, kjo tregon se ky është vetëm një nga rreziqet, por jo më i rëndësishmi, sepse, pavarësisht çdo gjëje, të dy komunitetet ende e perceptojnë Kosovën si shoqëri multietnike, edhe pse siç pritej shqiptarët e Kosovës disi më shumë (83%) në krahasim me serbët e Kosovës (74%).[28] Për këtë arsye shkaqet e kësaj situate duhen kërkuar në analizën e punës së institucioneve.

Kur bëhet fjalë për institucionet, hulumtimet e opinionit publik tregojnë një dallim statistikisht domethënës në nivelin e besimit në institucionet e zbatimit të ligjit në mesin e shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës, ku këta të fundit kanë një nivel dukshëm më të ulët besimi. Nga kjo, në mënyrë indirekte mund të vihet në përfundim se ka një ndryshim në qasjen ndaj institucioneve dhe qëndrimin e tyre ndaj grupeve të ndryshme etnike, që është konstatim i mbështetur nga raportet e bashkësisë ndërkombëtare. Kështu, për shembull, raportet vjetore të Departamentit të Punëve të Jashtme të SHBA-ve (ang. State Department) theksojnë të njëjtin trend, ku kapaciteti i pamjaftueshëm, ose mungesa e vullnetit, ceken si probleme kyçe në zbatimin e ligjeve që përgjithësisht vetëm në letër lejojnë qasje të barabartë në të drejta, e cila qasje në praktikë mungon (ang. lack of enforcement).[29] Për shembull, ky raport thotë se mbi 95% e të gjitha kërkesave pranë gjykatave të Kosovës lidhur me të drejtat pronësore rrjedhin nga serbët. Gjithashtu, thuhet se ka probleme të theksuara me të drejtat e njeriut kur bëhet fjalë për komunitetet joshumicë, duke përfshirë lirinë e shprehjes, lëvizjes apo manifestimit të identitetit kombëtar, si dhe incidente individuale të pa hetuara të drejtuara kundër pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë.

Hulumtimet, në kuadër të komunitetit serb, kanë treguar se ekziston një shqetësim i madh për largimin e të rinjve nga zonat me popullatë serbe. Një nga kërcënimet kryesore për mbijetesën e komunitetit serb është emigrimi i popullatës, prandaj për shkak të pasigurisë dhe kornizës joadekuate institucionale për zgjidhjen e problemeve të sigurisë, vetëm çdo i dyti serb e sheh veten në Kosovë në pesë vjet, shumica e të cilëve janë më të rinjtë.[30]

27 Balaj, Shpat, dhe Sejdiu, Gramos. (2022). *What are the Kosovo Citizen's Perceptions on itner-ethnic relations: Fostering Inter-ethnic Relations and Reconciliation Survey Results.* Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Prishtinë
28 Ibid.
29 US State Deparment, *Kosovo 2022 Human Rights Report.* https://www.state.gov/wp-content/uploads/2023/02/415610_KOSOVO-2022-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf
30 Ibid.

Arsyet për këtë gjendje së pari duhet të kërkohen në incidentet e sigurisë në veri, por edhe në pjesët tjera të Kosovës ku është i pranishëm komuniteti serb. Këto incidente, përveç se janë shtuar në numër që nga fillimi i krizës vitin e kaluar, po shtohen edhe në intensitet. Përkeqësimi i kushteve të sigurisë në vitin 2023 është vazhdimësi e situatës së tensionuar nga fundi i vitit të kaluar, e cila u shoqërua edhe me një ndjenjë të shtuar të pasigurisë, për të cilën tashmë është raportuar më në detaje.[31]

Viti filloi me një incident në komunën e Shtërpcës, në prag të Krishtlindjeve, pra më 6 janar 2023, kur një sulmues i panjohur i cili më vonë u arrestua qëlloi nga një makinë një djalë (11) dhe një të ri (21).[32] Në disa raste, pjesëtarët e Policisë Speciale të Kosovës hapën zjarr ndaj automjeteve civile nga një pikë kontrolli në vendbanimin Bistrica, duke përfshirë edhe rastin e 23 janarit, kur një person mbeti i plagosur.[33] Njësitet speciale të Policisë së Kosovës gjatë vitit 2023 janë vazhdimisht të pranishme në veri të Kosovës dhe kanë marrë pjesë në incidente të shumta, që edhe nëse ndoshta ky nuk ishte qëllimi i tyre kryesor, e frikësuan shumë popullsinë lokale. Incidentet, ndonëse kanë ndodhur gjatë gjithë kohës, u shtuan sidomos pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale në katër komuna në veri më 23 prill dhe protestave të dhunshme, pas të cilave Policia Speciale e Kosovës shtoi prezencën dhe arrestimet e tyre (më shumë informata për zgjedhjet në kapitullin vijues). [34] Mediat lokale nga veriu i Kosovës kanë regjistruar incidente të njësive speciale me të mitur,[35] dhe incidente gjatë bastisjeve të banesave dhe shtëpive në veri të Kosovës dhe të ngjashme.[36] Situata u përshkallëzua më tej për shkak të reagimeve të Beogradit, kur kah mesi i qershorit tre policë të Kosovës u arrestuan nga forcat serbe, gjë të cilën Prishtina e interpretoi si një "rrëmbim" në hakmarrje të arrestimeve të mëparshme të serbëve në veri të Kosovës.[37] Ndonëse publiku nuk është i sigurt se ku ka ndodhur ky arrestim/rrëmbim për shkak të pikëpamjeve të kundërta të autoriteteve të Beogradit dhe Prishtinës, incidenti sigurisht që ka ndikuar negativisht në ndjenjën e sigurisë personale të banorëve të veriut të Kosovës.

31 Psh. shih: Humani centar Mitrovica, *Bezbednost i etnički odnosi na Kosovu: pozicija srpske zajednice,* maj 2023, dhe Lulzim Peci, (qershor 2023). *Jačanje institucionih odgovora na bezbednosne incidente u nevećinskim zajednicama (srpskim),* OJQ Aktiv, Mitrovicë.

32 Budimir Ničić, *Dečak i mladić ranjeni kod Štrpca, napadač uhapšen,* 6. janar 2023. Zëri i Amerikës https://www.glasamerike.net/a/decak-i-mladic-ranjeni-kod-strpca-napadac-uhapsen-/6907334.html

33 *Bezbednost i etnički odnosi na Kosovu: pozicija srpske zajednice,* f. 16.

34 Psh. shih lajmet e muajit shkurt 2023: KoSSev info, *Mijačić: Mi išli da obeležimo međunarodnu turističku stazu, specijalci nas jurili kao teroriste*, https://kossev.info/mijacic-mi-isli-da-obelezimo-turisticku-stazu-specijalci-nas-jurili-kao-teroriste/

35 KoSSev Info, 17 qershor 2023. *SL: Specijalci napali maloletnike u Žitkovcu; KBC potvrdio da su hospitalizovani; KP demantuje da su njihovi pripadnici fizički nasrnuli na njih*, https://kossev.info/srpska-lista-specijalci-napali-maloletnike-u-zitkovcu-kbc-potvrdio-da-su-hospitalizovani-policija-demantuje-da-su-njihovi-pripadnici-fizicki-nasrnuli-na-njih/

36 KoSSev Info, 23 qershor 2023. *U Zvečanu specijalci i oklopnjaci; KP: Nema hapšenja, sumnja se da je u vozilu eksploziv, čeka se KFOR,* https://kossev.info/kp-nema-hapsenja-u-zvecanu-pregledamo-vozilo-za-koje-sumnjamo-da-se-u-njemu-nalazi-oruzje/

37 KoSSev Info, 14 qershor 2023. *Kurti: Policajci „kidnapovani" – osveta za jučerašnje hapšenje M.M. u Mitrovici*, https://kossev.info/kurti-policajci-kidnapovani-osveta-za-jucerasnje-hapsenje-m-m-u-mitrovici/

Për shkak të tensioneve të shtuara, përfaqësuesit ndërkombëtarë kërkuan de-përshkallëzim nga të dyja palët, me theks të veçantë në përgjegjësinë e Qeverisë së Kosovës për situatën në veri. Bashkimi Evropian insiston që Qeveria e Kosovës të zbatojë planin trepikësh, i cili përfshin tërheqjen e njësive speciale të Policisë së Kosovës, largimin e kryetarëve të sapo zgjedhur nga ndërtesat komunale dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja lokale.[38] Për shkak të refuzimit për zbatimin e këtij plani, Qeverisë së Kosovës, nga qershori 2023 iu vendosën sanksione, d.m.th. masat e synuara nga Bashkimi Evropian dhe partnerët ndërkombëtarë të cilat janë ende në fuqi.[39]

38 KoSSev info, 2 qershor 2023. *Američki senator sa koracima za deeskalaciju situacije: Specijalci da se povuku, završe protesti, zakažu izbori…* https://kossev.info/americki-senator-sa-koracima-za-deeskalaciju-situacije-specijalci-da-se-povuku-zavrse-protesti-zakazu-izbori/

39 Alice Taylor, 5 korrik 2023. First effects of EU sanctions sting Kosovo. https://www.euractiv.com/section/politics/news/first-effects-of-eu-sanctions-sting-kosovo/

Zgjedhjet lokale në veri – pjesëmarrja politike e serbëve të Kosovës

Fokusi i dialogut u zhvendos nga zbatimi i marrëveshjeve të arritura në fillim të vitit në zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale që u mbajtën më 23 prill në katër komuna me shumicë serbe në veri, të cilat po ashtu u pasuan me një sërë incidentesh. Zgjedhjet u organizuan si përgjigje ndaj krizës së shkaktuar nga mospajtimet rreth përdorimit të targave dhe tërheqjes së Listës Serbe dhe shumicës së serbëve lokalë nga institucionet lokale në veri të Kosovës në nëntor të vitit 2022. Pasi Lista Serbe njoftoi për bojkotimin e zgjedhjeve të prillit, kandidatët serbë morën pjesë vetëm në dy komuna. Zgjedhjet janë shpallur për kryetarë komunash (në të katër komunat)[40] dhe kuvendet komunale (në komunën Leposaviqit dhe Zveçanit),[41] në të cilat për shkak të bojkotit përfaqësuesit e serbëve nuk kandiduan. Dalja ishte ndërmjet një dhe gjashtë për qind dhe për shkak të pjesëmarrjes së ulët të votuesve, pra rreth 1500 nga gjithsej 45.000 votues të regjistruar, supozohet se votuan vetëm 13 serbë.[42] Në rrethana të këtilla, katër kandidatë shqiptarë fituan, dy nga partia në pushtet LVV dhe dy nga partia opozitare PDK. Zyrtarët nga Beogradi i quajtën ata disa herë "kryetarë të rremë"[43]

Një muaj pas përfundimit të zgjedhjeve, liderët e rinj komunalë, të shoqëruar nga njësitet speciale të policisë, hynë në ndërtesat komunale. Kjo, në Mitrovicën e Veriut u bë më herët dhe pa incidente, ndërsa në Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq ndodhi me përleshje me serbët e mbledhur. Serbët lokalë të punësuar në komuna kryesisht refuzuan të bashkëpunonin me kryetarët e rinj, u përpoqën të pengonin ardhjen e tyre dhe u larguan nga vendet e tyre të punës në komunë. Demonstruesit, në mëngjesin e 29 majit, u mblodhën rreth objekteve komunale dhe formuan një rreth, dhe përveç policisë së Kosovës, e cila ishte brenda ndërtesave, gjatë ditës në përpjekje për të larguar demonstruesit erdhën edhe pjesëtarët e KFOR-it. Me këtë rast, për shkak të përdorimit të armëve të zjarrit erdhi deri te përleshje të rënda me dhjetëra të plagosur, që në më shumë se dhjetë vjet ishte konflikti i parë serioz ndërmjet serbëve të Kosovës dhe KFOR-it.[44] Si pasojë e këtij zhvillimi të ngjarjeve, pas incidenteve, tensioni në veri të Kosovës u ngrit edhe për shkak të arrestimit të një numri të madh të serbëve lokalë nga policia speciale e Kosovës për gjoja organizim të demonstratave të dhunshme.

Përkundër kësaj, organet e reja të vetëqeverisjes lokale filluan punën e tyre. Për rrjedhojë të bojkotit nga serbët lokalë, bashkësia ndërkombëtare këmbënguli që kryetarët e rinj në katër komunat në veri të Kosovës gjatë kryerjes së detyrave[45] të tyre të marrin një rol teknik e jo politik[46]. Mirëpo, ajo që ka ndodhur në praktikë është se, për shembull, në

40 Dokumentacioni zgjedhor në gjuhën serbe është në dispozicion në https://kqz-ks.org/sr/izbori-za-predsednike-opstina/lojjet-per-kryetar-komune-2022/.

41 Dokumentacioni zgjedhor në gjuhën serbe është në dispozicion në https://kqz-ks.org/sr/izbori-za-skupstine-opstina/lojjet-e-parakohshme-per-kuvendet-e-komunave-zvecan-dhe-leposaviq-2022/.

42 BBC News në serbisht: Lokalni izbori na severu Kosova: Glasalo ukupno nešto više od 1.500 ljudi, od toga samo 13 Srba - kaže Beograd, 23 prill 2023. https://www.bbc.com/serbian/lat/balkan-65362757

43 „Vučić: Srbija spremna za kompromise, ali je potrebno povući „lažne gradonačelnike" na severu", Nova S, 12. 6. 2023.

44 BBC News në serbisht: Snimak sukoba demonstranata i KFOR-a na severu Kosova, protest u Beogradu, 30 maj 2023. https://www.bbc.com/serbian/lat/balkan-65756320

45 https://kossev.info/ponovo-stejt-department-odluka-kosovske-vlade-da-prisilno-pristupi-opstinama-na-severu-nepotrebno-eskalirala-tenzije/

46 https://www.euractiv.com/section/politics/news/north-kosovo-mayors-to-be-sworn-in-amid-strife-with-belgrade/

komunën e Mitrovicës së Veriut, vendimet e para kanë qenë të karakterit politik dhe janë marrë pa marrë parasysh interesat dhe nevojat realisht prioritare të qytetarëve: hapja e urës kryesore të Mitrovicës për qarkullimin e udhëtarëve (për të cilën nuk ka kushte sigurie) dhe anëtarësimi në Asociacionin e Komunave të Kosovës (si një hap që kinse do të parandalonte dhe do ta bënte të pakuptimtë formimin e AKS-së të paraparë në marrëveshjet e Brukselit). Këtu duhet theksuar se në ueb faqen e komunës asnjë nga këto vendime nuk është në dispozicion në gjuhën serbe.[47]

Pasi që në ditën e zgjedhjeve ishte e qartë se organet e vetëqeverisjes lokale të krijuara në këtë mënyrë nuk janë legjitime për shkak të bojkotit të shumicës së popullatës lokale, në nivel qendror si pasojë e drejtpërdrejtë e presioneve të bashkësisë ndërkombëtare, është marrë vendim për përsëritjen e zgjedhjeve në katër komuna. Si rrjedhojë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokale ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr. 02/2023 për iniciativën e qytetarëve për largimin e kryetarit të komunës nga funksioni[48]. Ky Udhëzim Administrativ shtjellon dispozitat e Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe si parakusht për zgjedhje të reja, përveç dorëheqjes së paraparë me ligj, kërkohet iniciativë për largim, për vlefshmërinë e së cilës vetë udhëzimi parasheh një përqindje të nevojshme të votuesve me të drejtë vote prej 20%.

Marrë parasysh që me diplomacinë e ndërmjetësuesve të pesëshes së madhe dhe bisedimeve në Bruksel u dakorduan hapat e ardhshëm, në përputhje me planin që të dyja palët "të lëvizin paralelisht hap pas hapi", pas pranimit dhe miratimit të statutit të Asociacionit të Komunave Serbe nga Prishtina, zgjedhjet lokale do të përsëriten në gjysmën e parë të vitit 2024. Presidenti i Serbisë tashmë nga mesi i tetorit u bëri thirrje serbëve të Kosovës që të dalin me iniciativë për zgjedhje të reja, që do të thotë se mbështetja e Beogradit për pjesëmarrje është e garantuar.[49] Konfirmim shtesë i këtij zhvillimi të ngjarjeve është edhe ndryshimi në kryesinë e Listës Serbe, sepse në fund të tetorit në mbledhjen e kësaj partie u zgjodh kryetari i ri dhe pesë nënkryetarë.[50] Kjo është një përpjekje e dukshme për të riemërtuar këtë parti në përgatitje për zgjedhje, dhe duke qenë se një pjesë e lidershipit të saj të mëparshëm ishte inkriminuar në rastin e Banjskës, ish nënkryetari i saj, Millan Radoiçiq, dha dorëheqje nga kjo pozitë.

Për dallim nga veriu i Kosovës, situata në zonat e banuara me serb në jug të Ibrit në periudhën e vëzhguar ka mbetur e pandryshuar edhe në këtë fushë. Në nivel qendror, në kuadër të braktisjes së institucioneve në nëntor 2022, me të njëjtin rast dhanë dorëheqje 10 deputetë që zinin vendet e rezervuara për komunitetin serb. Megjithatë, ata shpejt u zëvendësuan nga 10 përfaqësues të rinj, të cilët që atëherë nuk marrin pjesë në mënyrë aktive në punimet e kuvendit, por vetëm ruajnë statusin e tyre. Kjo në mënyrë efektive e pengoi kuvendin të miraton ligje juridikisht të vlefshme me rëndësi jetike.

47 https://kk.rks-gov.net/mitroviceeveriut/sr/category/skupstina/odluke-sr-skupstina/
48 Teksti në dispozicion në https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/09/02-619-4-2023-2.pdf.
49 Kosovo Online. Vucic called Serbs from Northern Kosovo to come forward withj an initiative for elections, 12 tetor 2023. https://www.kosovo-online.com/en/news/politics/vucic-called-serbs-northern-kosovo-come-forward-initiative-elections-12-10-2023
50 KoSSev Info. Dr Zlatan Elek novi predsednik Srpske liste, izabrano i novih pet potpredsednika, 24 tetor 2023. https://kossev.info/zlatan-elek-novi-predsednik-srpske-liste/

Rreziqet e sigurisë dhe pasojat për ushtrimin e të drejtave të tjera

Kjo pjesë e raportit trajton analizën e problemeve që kanë lindur si pasojë e sfidave të sigurisë të eleboruara më lartë. Pasi që siguria është në vend të parë kur bëhet fjalë për preokupimin e serbëve lokalë, institucioneve të Kosovës dhe komunitetit ndërkombëtar, trendet negative u përhapën edhe në fusha të tjera dhe e përkeqësuan situatën lidhur me gëzimin e të drejtave të tjera të garantuara. Gjithashtu, në këto zona u regjistruan një numër i madh i incidenteve të sigurisë, që janë tregues i drejtpërdrejtë i cenimit të të drejtave të popullsisë lokale.

Sigurimi i të drejtave pronësore

Qeveria e Kosovës, për shkak të sfidave të sigurisë, që nga shtatori i vitit 2021 po përpiqet të forcojë prezencën e njësive speciale në veri të Kosovës, e cila ka synuar edhe ndryshimin e karakterit të pranisë së tyre, nga e përkohshme në atë të përhershme. Si pasojë e synimit të ndërtimit të bazave në veri të Kosovës, prona e një numri të madh të njerëzve në komunën e Leposaviqit dhe Zubin Potokut u uzurpua, dhe për të njëjtat pastaj u iniciua procedura e shpronësimit. Kjo është në kundërshtim me radhën e hapave të parashikuar me Ligjin nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, ndërsa vetë dokumentacioni në procedurë përmban një sërë të dhënash materialisht të pasakta.[51]

Sa i përket shpronësimit, janë mbajtur dy seanca publike (15 shkurt 2023 në Leposaviq dhe 21 shkurt 2023 në Zubin Potok[52]), të cilat u pasuan me marrjen e një vendimi paraprak për shpronësim[53], ndërsa vendimi përfundimtar ndonëse ishte i planifikuar, u shty për një njoftim të dytë[54]. Po ashtu, kundër vendimit paraprak janë iniciuar një numër i madh i kontesteve pranë gjykatave kompetente, të cilat aktualisht janë në proces dhe në të cilat janë marrë vetëm vendime që refuzojnë masat e përkohshme të propozuara.[55] Kjo është veçanërisht e rëndësishme pasi që në letrën e autoriteteve të Kosovës me të cilën ofrohet përgjigje rreth analizës juridike të kësaj situate të bërë nga bashkësia ndërkombëtare, thuhet se këto procedura kanë përfunduar, gjegjësisht se është vendosur në themel, mirëpo një gjë e tillë nuk korrespondon fare me të vërtetën[56].

Nga ana materiale, këto raste janë të kundërligjshme sepse ndërtimi i bazave nuk parashikohet shprehimisht me ligjin në fjalë. Kjo mangësi u mundua të tejkalohet me hartimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit në fjalë menjëherë pas mbajtjes së dëgjimeve publike, i cili në momentin e hartimit të këtij raporti ende nuk ka hyrë në procedurë parlamentare, por procedura e konsultimit ka përfunduar në shtator, dhe i cili shprehimisht si qëllim të lejuar e njeh ndërtimin e bazave[57].

Këto raste të shpronësimit në dy komuna në veri të Kosovës tregojnë pafuqinë e sistemit juridik të Kosovës për të vendosur një sundim funksional të ligjit për komunitetin serb, sepse vetë qeveria e Kosovës në mënyrë të gabuar i zbaton apo i shkel ligjet e veta dhe

51 Teksti në gjuhën angleze i disponueshëm në https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2636&langid=2.
52 Autori mori pjesë në të dyja diskutimet.
53 Teksti i disponueshëm në: https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=74912.
54 Burimi në dispozicion të autorit.
55 Burimi në dispozicion të autorit.
56 Burimi në dispozicion të autorit.
57 Të gjitha dokumentet në dispozicion në https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41809.

më pas në hapin e parë tenton ta justifikojë me zbatimin sipërfaqësor të procedurave, dhe në hapin e dytë me ndryshimin e ligjeve që do të legalizonin më pas veprimet e kundërligjshme. Krahas gjithë kësaj, procedurat ligjore kundër veprimeve të tilla të Qeverisë së Kosovës mund të zhvillohen ekskluzivisht para gjykatave të Kosovës, ku për shkak të braktisjes së institucioneve nga serbët vendas gjendja është përkeqësuar sistematikisht. Shpronësimi ishte edhe objekt i një njoftimi zyrtar nga përfaqësuesit e BE[58], si dhe një analize ligjore ndaj të cilës, siç u theksua tashmë, autoritetet kosovare iu përgjigjën në shtator.[59]

Kur bëhet fjalë për të drejtën në pronë, një shembull ilustrues i dualizmit ligjor në zonat e banuara nga serbët në jug të Ibrit është qendra e skijimit në Brezovicë. Kjo qendër skijimi funksionon paralelisht në sistemin juridik të Serbisë dhe Kosovës për gati 20 vjet. Në sistemin serb bëhet fjalë ndërmarrjen Ski Centar Brezovica sh.p.k., e cila është themeluar në vitin 2008 si ndërmarrje e përbashkët e Fondit Inex Intereksport a.d. (pasardhëse e ish sistemit Ineks, i cili ndërtoi qendrën e skijimit) dhe ndërmarrjes publike Skijališta Srbije (Ski Resort Serbia). Në sistemin kosovar, megjithatë, bëhet fjalë për disa përpjekje të njëpasnjëshme për ta shndërruar qendrën e skijimit në një ndërmarrje shoqërore nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Të gjitha përpjekjet ishin të pasuksesshme, derisa në vitin 2021 nuk u regjistrua ndërmarrja sociale Inex Šar Planina Brezovica, bordi i përkohshëm i së cilës u emërua në vitin 2022 nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Kështu, përfundimisht u krye marrja e ligjshme e qendrës së skijimit nga autoritetet e Kosovës, por pa zbatimin e procedurave të parashikuara me ligj për regjistrimin e kërkesave pronësore, dhe për këtë arsye nuk mund të karakterizohet si asgjë tjetër veçse konfiskim[60]. Në vitin 2023 ky proces u rëndua edhe më shumë pasi që anëtarët e rinj të bordit u emëruan në kundërshtim me marrëveshjen me komunën e Shtërpcës, për të cilën përfaqësuesit e vetë komunës deklarojnë se është arritur në vitin 2021 dhe e cila parasheh që të gjithë anëtarët e bordit të jenë banorë të kësaj komune[61].

Është e rëndësishme të konstatohet se të dyja këto raste përfaqësojnë shkelje të nenit 16 të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare[62], i zbatueshëm drejtpërsëdrejti sipas nenit 2 të Kushtetutës së Kosovës, i cili ndalon masat që ndryshojnë artificialisht raportin e popullsisë në zonat e banuara nga pjesëtarë të pakicave kombëtare dhe që synojnë të kufizojnë të drejtat dhe liritë që rrjedhin nga parimet që përmban kjo konventë. Duke pasur parasysh se ky lloj shpronësimi prek pothuajse pa përjashtim komunitetin serb dhe ndikon në ndarjen e dy njësive gjeografikisht unike dhe homogjene kombëtare (komunat e Leposaviqit/Zubin Potok dhe Shtërpcës) me ndërtimin e bazave të forcave të sigurisë, përkatësisht duke hequr kontrollin mbi një resurs bazë ekonomik, padyshim që bie nën këtë nen të Konventës Kuadër. Megjithatë, për shkak të mungesës së mekanizmave efektivë të mbrojtjes ndërkombëtare, pasi që Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës, kjo është reduktuar në një deklaratë të thjeshtë pa asnjë pasojë juridike.

58 Njoftimi i EEAS i datës 12 maj 2023. Teksti në gjuhën angleze në dispozicion në https://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/statement-governments-decision-expropriation-land-public-interest-municipalities-leposaviq_en?s=321.

59 Burimi i njohur për autorët e raportit.

60 Rregulloret e kërkojnë këtë janë në dispozicion në https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=3,31.

61 Njoftimi i komunës në dispozicion në https://www.facebook.com/strpceopstina/posts/640192551476879?ref=embed_post.

62 Teksti në gjuhën angleze i disponueshëm në https://rm.coe.int/16800c10cf.

Disbalanca ekonomike

Në këtë periudhë, për shkak të përkeqësimit të situatës së sigurisë, cenohen edhe të drejtat ekonomike të serbëve në veri të Kosovës. Krahas të gjitha problemeve të tjera, Qeveria e Kosovës mori vendim për ndalimin e importit të mallrave me origjinë nga Republika e Serbisë, gjë që e vështirësoi dukshëm furnizimin e popullatës lokale me artikujt e nevojshëm elementarë. Është e pamundur të përcaktohet se me cilin akt juridik ka nisur kriza në këtë fushë, sepse nuk ka vendim të shpallur publikisht të Qeverisë së Kosovës për ndalimin e importit të mallrave nga Serbia, por në të vërtetë ai zbatohet dhe diskutohet në publik. Përveç kësaj, është shumë e vështirë të vlerësohen efektet e këtij ndalimi faktik, por ato mund të dalin pjesërisht nga të dhënat statistikore mbi shkëmbimin tregtar nga burimet zyrtare të Serbisë dhe Kosovës. Bazuar në të dhënat zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, të paraqitura në tabelën e mëposhtme, tregohet lëvizja e nivelit të importeve nga Serbia në Kosovë në periudhën gusht 2022 deri në korrik 2023, gjithashtu mund të shihet se edhe pse importet nga Serbia nuk janë ndaluar plotësisht, ka pasur një rënie të ndjeshme.[63]

Tabela 1: Vendet nga rajoni të renditura sipas pjesëmarrjes në importin e përgjithshëm në Kosovë

Renditja	Vendi	Përqindja e importeve të përgjithshme
1	Shqipëria	5,5%
2	Maqedonia e Veriut	4,5%
3	Serbia	2,1%

Është e padiskutueshme se pozita ekonomike e komunitetit serb është përkeqësuar si rezultat i kësaj mase, veçanërisht në zonat si katër komunat në veri, të cilat për shkak të pozitës gjeografike të tyre dhe faktorëve të tjerë varen në thelb nga shkëmbimi tregtar me Serbinë. Efekt dytësor i ndalimit faktik është derdhja e importeve në zonën gri përmes kalimeve alternative, që së bashku me praninë e shtuar të forcave të sigurisë në katër komuna në veri të Kosovës, thellon edhe më shumë krizën e sigurisë. Si pasojë e kësaj, erdhi deri te disa incidentet të kontrabandës së mallrave, duke përfshirë edhe disa që përfshijnë përdorimin e armëve të zjarrit.[64] Po ashtu, me veprimet e policisë së Kosovës janë konfiskuar vetura dhe mallra të kontrabanduara, gjë që e ndërlikon edhe më shumë furnizimin e popullatës lokale dhe e shton mosbesimin në institucionet e Prishtinës.[65] Vendimi i qeverisë së Kosovës për ndalimin e importit të mallrave nga Serbia është në kundërshtim me MSA-në[66] dhe marrëveshjen e CEFTA-s[67], si dhe me idenë e një tregu unik, i cili është parakusht për marrjen e mjeteve nga Plani i Rritjes (Growth Plan) së BE-së për Ballkanin Perëndimor, por edhe në përgjithësi me progresin në rrugën drejt BE-së.

63 Në dispozicion në adresën https://www.ceicdata.com/en/kosovo/imports-by-country/imports-other-europe-serbia.

64 Shih: RT Balkan. Kosovska policija optužuje Srbe za krijumčarenje robe: U Leposaviću došlo do razmene vatre, 19 gusht 2023. https://lat.rt.rs/srbija-i-balkan/46031-leposavic-policija-krijumcarenje-srbi/ dhe Al Jazeera Krijumčari pucali na policiju na sjeveru Kosova, 11 gusht 2023. https://balkans.aljazeera.net/news/balkan/2023/8/11/krijumcari-pucali-na-policiju-na-sjeveru-kosova

65 Radio Kontakt plus. Zvečan: Zaplenjeno pet vozila zbog sumnje na krijumčarenje, 12 tetor 2023 https://radiokontaktplus.org/glavna/zvecan-zaplenjeno-pet-vozila-zbog-sumnje-na-krijumcarenje/47059/

66 https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-10728-2015-REV-1/en/pdf

67 https://cefta.int/what-we-do/trade-in-goods/

Sfidat në ruajtjen e vlerave demokratike

Ky seksion analizon një grup specifik të lirive politike të garantuara me kushtetutë dhe përfshinë liritë e medias dhe të drejtën e përdorimit të gjuhës.

Kur bëhet fjalë për liritë e medias, ato janë të garantuara me Kushtetutën e Kosovës, por gjatë 20 viteve të kaluara këto liri nuk janë realizuar në mënyrën e duhur. Gjatë vitit 2023, në kuadër të përshkallëzimit të situatës në katër komuna në veri të Kosovës, ka pasur disa raste të sulmeve ndaj gazetarëve, si të kombësisë serbe ashtu edhe shqiptare. Krahas këtyre rasteve, në evidencën e Asociacionit të Gazetarëve të Serbisë (AGS), janë evidentuar si në vijim:

- 16 raste te pengesave në kryerjen e detyrës;
- 8 raste sulmesh fizike;
- 2 raste të kërcënimeve;
- 2 raste presioni ndaj gazetarëve [68]

Së fundi, ndalimi i importeve nga Serbia ndikoi edhe në mosdisponueshmërinë e mediave të shkruara serbe në mjediset serbe në Kosovë, dhe për popullsinë lokale vështirësoi ofrimin e informacionit në kohë.

Kur bëhet fjalë për të drejtën e përdorimit të gjuhës, ajo i takon korpusit të të drejtave të komuniteteve, ndërsa gjuha serbe së bashku me gjuhën shqipe është paraparë si gjuhë zyrtare në nenin 5, paragrafi 1. Ngjashëm me liritë e medias, kjo e drejtë nuk u ushtrua siç duhet[69]. Në këtë raport janë cekur shembuj ku nuk respektohet e drejta e përdorimit të gjuhës, gjegjësisht, kur dokumentet zyrtare nuk janë të disponueshme në gjuhën serbe:

- Institucionet/dokumentacioni zgjedhor - Vendimi i Komisionit Qendror për konfirmimin e listës përfundimtare zgjedhore për katër komunat e veriut;[70]
- Institucionet/vendimet e vetëqeverisjes lokale - vendimet e marra nga organet e sapo zgjedhura të vetëqeverisjes lokale nuk janë në dispozicion në gjuhën serbe;[71]
- Të drejtat pronësore - dokumentacioni në procedurën e shpronësimit në disa raste nuk është dorëzuar në gjuhën serbe.[72]

Përveç kësaj, disa ministri, si Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Mbrojtjes apo Ministria e Punëve të Jashtme, nuk kanë dërguar asnjëherë për mediat që raportojnë në gjuhën serbe komunikatë në gjuhën përkatëse. Një shembull posaçërisht ilustrues është Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e cila çdo dy ditë për media ofron parashikimin e motit vetëm në gjuhën shqipe.

68 Më shumë rreth kësaj në https://www.uns.org.rs/sr/desk/Drustvo-novinara-kim/149891/novinari-medija-na-srpskom-na-kim-na-dogadjajima-i-dalje-najcesce-bez-prevoda- sa-albansko-jezika.html.
69 Më shumë rreth kësaj në publikimin e Aktivit në dispozicion në https://ngoaktiv.org/wp-content/uploads/2023/01/Sluzbena-dvojezicnost-na-Kosovo-%E2%80%93-kljucni-preduslovi-i-izazovi.pdf
70 https://kqz-ks.org/sr/izbori-za-predsednike-opstina/zgjedhjet-per-kryetar-komune-2022/
71 https://kk.rks-gov.net/leposaviq/sr/document_category/vendimet-sr/
72 Burimi i njohur për autorët e raportit.

Dialogu i Brukselit: Nga normalizimi i marrëdhënieve në menaxhimin e krizës

Pasi propozimi gjermano-francez u pranua nga Beogradi dhe Prishtina në fillim të vitit në Bruksel dhe Ohër, entuziazmi u shua shpejt dhe ndërmjetësuesve ndërkombëtarë iu desh të zhvendosnin fokusin e tyre nga normalizimi i marrëdhënieve në menaxhimin e krizave dhe eliminimin e rreziqeve të menjëhershme të sigurisë. Beogradi, gjatë vitit 2023, vazhdoi me insistimin për primatin e obligimit të Prishtinës për të formuar Asociacionin e Komunave Serbe, por edhe me përsëritjen se qeveria e Albin Kurtit e trajton komunitetin serb në Kosovë në mënyrë radikale dhe të dhunshme, ndërsa Prishtina insiston në mosndërhyrjen e Beogradit në çështjet e brendshme të Kosovës dhe i redukton bisedimet, në pritje që Beogradi të ndërmarrë hapin e njohjes së pavarësisë.

Takimet e punës të ciklit të dialogut teknik në nivel të krerëve të ekipeve negociatore të dy palëve nuk sollën progres konkret. Pas takimit të 15 majit, shefi i delegacionit serb, Petar Petkoviq, ka akuzuar biseduesin kosovar, Besnik Bislimi, se "me ndërhyrje të ndryshme dëshiron të jap moskuptim rrjedhës së mëtutjeshme të bisedës", "as që ka dashur të diskutojnë zbatimin e dispozitave të disa marrëveshjeve për Asociacionin e Komunave Serbe"; në përgjithësi, ai palën tjetër e akuzoi për pengim.[73] Pavarësisht detajeve të takimeve individuale, deri më tani nuk është arritur pajtueshmëria e dy palëve për zbatimin e marrëveshjes.

Megjithatë, gjithçka u përmbys pas incidentit në Banjskë. Edhe pse kanë kaluar gati dy muaj nga kjo ngjarje, zyrtarisht ende pak dihet për incidentin në veri të Kosovës, ku një grup i armatosur i serbëve u përplas me policinë e Kosovës. Shumica e zyrtarëve perëndimorë dhe evropianë kanë shprehur shqetësimin për mundësinë e kalimit të incidentit në konflikt të armatosur, si dhe shqetësimet për të ardhmen e dialogut tashmë të bllokuar midis Beogradit dhe Prishtinës. Këto frika u nxitën edhe më shumë nga fakti se Serbia ngriti nivelin e gatishmërisë luftarake dhe vendosi ushtrinë përgjatë zonës së sigurisë tokësore, nga ku për shkak të presionit ndërkombëtar u tërhoq disa ditë më vonë.[74]

Për të zgjidhur krizën, kryeministri i Kosovës Albin Kurti dhe presidenti serb Aleksandar Vuçiq në fund të tetorit në Bruksel morën pjesë në takime të ndara me liderët e Francës, Gjermanisë dhe Italisë, të shoqëruar nga Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Politikë të Jashtme, Joseph Borelli. Dy palët negociuese nuk janë takuar asnjëherë, dhe në një komunikatë të publikuar nga Shërbimi Evropian për Çështjet e Jashtme, shprehet pakënaqësia për mos arritjen e marrëveshjes ndërmjet dy palëve.[75] Megjithatë, diplomacia e ndërmjetësuesve para takimit, si dhe deklaratat pas takimit, duket se konfirmojnë se ka pasur një hap para në proces.

Së pari, incidenti në veri të Kosovës barazoi pozitat e të dyja palëve në dialogun e Brukselit. Më parë, në mesin e ndërmjetësuesve ndërkombëtarë, Beogradi shihej si një palë më konstruktive sesa liderët në Prishtinë, të cilët për këtë arsye që nga qershori 2023 janë nën masat restriktive të BE-së. Ky qëndrim ndryshoi pas Banjskës dhe Beogradi tani

73 „Petković: Bisljimi obesmišljavao razgovor, kada spomenem ZSO, kaže da prvi put čuje šta je to", Nova S, 15. 5. 2023.
74 Le Monde, US calls for de-escalation as Serbian military build-up raises tensions on Kosovo border, 29 shtator 2023. https://www.lemonde.fr/en/international/article/2023/09/29/us-calls-for-de-escalation-as-serbian-military-build-up-raises-tensions-on-kosovo-border_6141862_4.html
75 Njoftimi i EEAS i datës 26 tetor 2023, në dispozicion në gjuhën angleze: https://www.eeas.europa.eu/eeas/kosovoserbia-press-remarks-high-representative-josep-borrell-after-meetings-president-serbia-and_en

akuzohet nga ndërmjetësuesit në dialog për destabilizim. Lideri i grupit të armatosur, Millan Radoiçiq, deri vonë lideri i LS, mori përgjegjësinë për organizimin e sulmit, duke mohuar çdo përfshirje të Qeverisë së Serbisë. Megjithatë, nuk mund të mohohen lidhjet e qarta politike ndërmjet lidershipit serb dhe Radoiçiqit. Veprimet e tij në veri të Kosovës bënë që Beogradi të humbasë reputacionin e tij si një anë më konstruktive në dialog, siç theksonin shpesh zyrtarët evropianë. Për këtë, duket se Serbia do të duhet të bëjë kompromise në dialog me synimin për të rifituar kredibilitetin e humbur, të gjitha nën kërcënimin e vendosjes së të njëjtave sanksione nën të cilat aktualisht ndodhet kryeministri i Kosovës. Ky është çmimi që Beogradi do të duhet të paguajë për incidentin në veri të Kosovës dhe për një hetim adekuat lidhur me të.

Së dyti, për kompromisin e mundshëm mësojmë nga një deklaratë tjetër, e cila u dha veçmas nga liderët evropianë Scholz, Macron dhe Meloni pas takimeve në Bruksel.[76] Në deklaratë, të dyja palëve u bëhen thirrje që "paralelisht, hap pas hapi" të ecin në drejtim të zbatimit të marrëveshjes. Diplomacia intensive ndërmjetësuese përpara takimit duket se ka bërë që të dyja palët të bien dakord për një udhërrëfyes. Hapi i parë kërkon që Prishtina të fillojë zyrtarisht procedurën për themelimin e Asociacionit të shumëpritur të Komunave Serbe (AKS), dhe duket se ka marrëveshje për përmbajtjen e statutit të tij, i cili më parë ishte pengesë në dialog. Nga ana tjetër, në veri priten zgjedhje të reja, ku situata është në ngërç pas bojkotit të mëparshëm të zgjedhjeve nga Lista Serbe (LS), dhe Beogradi tashmë ka mbështetur pjesëmarrjen e serbëve. LS kohët e fundit ndryshoi udhëheqësinë dhe u riemërua, duke synuar të mbetet një lojtar kyç politik, por duke njoftuar se "vendimet politike do të merren gjithmonë në koordinim me Beogradin zyrtar në interes të të gjithë serbëve."[77] Në fillim të tetorit, presidenti i Serbisë u bëri thirrje serbëve të Kosovës që të dalin me një iniciativë për zgjedhjet lokale, duke i dhënë kështu mbështetje Beogradit për pjesëmarrje politike. Kjo pritet të ndodh në gjysmën e parë të vitit 2024, për shkak të procedurave mjaft komplekse zgjedhore, por pas formimit të rregullt të qeverive komunale lokale, AKS më në fund mund të themelohet. Duke marrë parasysh se zgjedhjet e jashtëzakonshme në Serbi do të mbahen më 17 dhjetor, gjasat janë të pakta që pika e kthesës të ndodhë para kësaj. Në fakt, duket se Beogradi ka arritur të blejë pak më shumë kohë, por viti i ardhshëm do të jetë vendimtar për përparimin real në sjelljen e Kosovës dhe Serbisë në rrugën e normalizimit të marrëdhënieve.

76 European Western Balkans, 27 tetor 2023. Macron, Scholz and Meloni call Kosovo to launch establishment of ASM and Serbia to deliver on de-facto recognition https://europeanwesternbalkans.com/2023/10/27/macron-scholz-and-meloni-call-kosovo-to-launch-establishment-of-asm-and-serbia-to-deliver-on-de-facto-recognition/

77 European Western Balkans, Serbian list gets new leadership, more Kosovo Serb parties are emergin, 26 tetor 2023. https://europeanwesternbalkans.com/2023/10/26/serbian-list-gets-new-leadership-more-kosovo-serb-parties-are-emerging/

PËRMBYLLJA DHE REKOMANDIMET

Nga të dhënat dhe konstatimet e paraqitura më lartë, është e pamohueshme që komuniteti serb në Kosovë gjendet në një krizë sigurie, mirëpo një gjë e tillë vlen edhe për tërë shoqërinë kosovare. Kjo krizë në disa fusha është më e madhja në dhjetë e më shumë vitet e fundit dhe është rezultat i marrëdhënieve thellësisht të trazuara si ndërmjet dy palëve në procesin e Brukselit, ashtu edhe në nivel lokal ndërmjet institucioneve kosovare dhe serbëve lokalë. Në këtë kontribuon edhe retorika nxitëse e pranishme shpesh në opinion, e cila përdoret çdo ditë nga zyrtarët në Beograd dhe Prishtinë, dhe përhapet në të dy komunitetet, duke thelluar edhe më tej mosbesimin tashmë të dëmtuar. Ajo që është edhe më e rrezikshme, serbët në Kosovë, në këtë kontekst, shihen nga prizmi i marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Një hendek i tillë ndërmjet asaj që (nuk) është rënë dakord dhe asaj që (nuk) është realizuar, nëse nuk zgjidhet në mënyrën e duhur, do të rezultojë në një përkeqësim shtesë të situatës, të thelluar nga efekti i përhapjes së krizës nga një zonë në tjetrën. Veçanërisht është i dukshëm problemi i mosbesimit, para së gjithash në forcat e sigurisë, si dhe në institucionet e Kosovës në të gjitha nivelet, gjë që çon në një lloj rrethi vicioz. Në atë rreth, si pasojë e privimit të legjitimitetit të institucioneve, humbet vullneti për pjesëmarrjen e popullatës lokale në punën e tyre dhe në këmbim ato institucione largohen gjithnjë e më shumë nga nevojat e qytetarëve. Ky nuk është një problem i ri, mirëpo situata në atë zonë sa vjen e përkeqësohet. [78]

Duke pasur parasysh të gjithë faktorët e lartpërmendur të sigurisë, juridik dhe politik, zgjidhja e krizës institucionale në nivel lokal në katër komuna në veri të Kosovës para së gjithash kërkon në mënyrë kumulative, si në vijim:

Sigurinë

→ Në planin afatshkurtër, normalizimi i punës së policisë në veri të Kosovës dhe riintegrimi i policëve serbë, si dhe përfaqësuesve të institucioneve të drejtësisë, është urgjentisht i nevojshëm. Beogradi, Prishtina dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të ndërmarrin hapa për të hetuar dhe informuar publikun për rrethanat e incidentit në Banjskë.
→ Në planin afatmesëm, është e nevojshme të zbatohen masa për ndërtimin e besimit, si ndërmjet autoriteteve qendrore dhe policëve të komandës rajonale të veriut, ashtu edhe mes popullsisë lokale.
→ Në planin afatgjatë, krahas përfaqësimit të serbëve "në letër", duhet të sigurohet edhe mundësia e integrimit real të pjesëtarëve të këtij komuniteti në institucionet e Kosovës, përmes mënjanimit të pengesave siç janë mosnjohja e gjuhës, avancimi në hierarki dhe të ngjashme.[79]
→ Është e domosdoshme që plani evropian trepikësh për deeskalimin e situatës në veri të Kosovës të zbatohet menjëherë.
→ Është e nevojshme të shqyrtohen modele për angazhimin e forcave speciale të policisë, në koordinim me autoritetet lokale mbi bazën e marrëveshjes, por edhe të zbatohen masa që do të siguronin praninë e komuniteteve pakicë në këto njësi dhe të ndërtohet besimi. Kjo është veçanërisht e rëndësishme pas veprimeve të fundit të per-

78 Për shembull, shikoni botimin tashmë tradicional të Aktivit, i cili mat, ndër të tjera, mosbesimin e qytetarëve ndaj institucioneve të Kosovës, https://ngoaktiv.org/wp-content/uploads/2023/03/FINAL-SRB-TREND.pdf
79 Elek, Bojan (2020). Policing in North Kosovo after Brussels Agreement. Balkans Policy Research Group, Prishtinë.

ceptuara si të njëanshme dhe shtypëse.

Vetëqeverisjen lokale

➞ Është e domosdoshme që hapat e nevojshëm që do të çonin në marrëveshje për statutin dhe, kur të plotësohen kushtet, formimin e Asociacionit të Komunave Serbe, të zbatohen urgjentisht.
➞ Është e domosdoshme që menjëherë të fillohet me krijimin e kushteve të favorshme për mbajtjen e zgjedhjeve lokale në katër komuna në veri të Kosovës me pjesëmarrjen e plotë të komunitetit serb. Nevoja kryesore është inkurajimi i pjesëmarrjes së serbëve lokalë në zgjedhje, si parakusht politik për legjitimitetin e qeverisë, me mbështetjen e Beogradit dhe komunitetit ndërkombëtar, me përpjekje maksimale për t'i bërë zgjedhjet sa më të sigurta, të lira dhe të ndershme aq sa edhe gjendja në terren lejon një gjë të tillë.

Të drejtat e tjera:

➞ Është i nevojshëm procedimi i të gjitha rasteve të cenimit të pronës private dhe publike, si dhe dënimi publik i incidenteve nga zyrtarë të pushtetit qendror dhe lokal.
➞ Është e nevojshme që masat kufizuese të hiqen sa më shpejt dhe të normalizohet qarkullimi i mallrave dhe shërbimeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.
➞ Të pezullohen të gjitha procedurat e shpronësimit në veri të Kosovës deri në njoftimin e radhës, ndërsa për dëmet e mundshme të kompensohen të gjithë personat e prekur.
➞ Është e nevojshme të garantohet siguria dhe liria e punës së të gjithë gazetarëve, me fokus të veçantë gazetarëve nga komunitetet pakicë;
➞ Të bëhen përpjekje shtesë në sigurimin e disponueshmërisë së të gjitha informatave relevante në gjuhën serbe.

Botues
OJQ AKTIV
Mbreti Pjetri I 183a, Mitrovicë e Veriut;
Qamil Hoxha 38, Prishtinë;
Kosovska 17, Beograd

Rreth botuesit
OJQ AKTIV

Autor
Bojan Elek

Redaktor
Miodrag Milićević

Zhvillimi dhe publikimi i këtij dokumenti është përkrahur nga programi I Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosova' i bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunimi (SDC), Suedia dhe Qeveria e Dukatës së Madhe të Luksemburgut. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e OJQ Aktiv dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e KCSF-së, SDC-së, Suedisë apo Luksemburgut.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden
Sverige

LUXEMBOURG
AID & DEVELOPMENT

KCSF
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION
FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE